



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 602, datë 04.12.2020**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ.MANJOLA XHAXHO DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE DHE NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.82, NR.83 DHE NR.85, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 04.12.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidatës për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, znj.Manjola Xhaxho” përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj.Manjola Xhaxho dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020,

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.*

2. Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.*

3. Në të dy rastet, afati i kandidimit është përcaktuar “*dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*”.

4. Me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.*

5. Në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar “*dy muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor*”.

6. Vendimet e Këshillit si më lart janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

7. Aktualisht kanë përfunduar afatet e pezulluara<sup>1</sup> dhe më pas të zgjatura<sup>2</sup> të kandidimit për të treja procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me vendimet e sipërcituara.

8. Brenda afatit të kandidimit, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, si dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020 ka kandiduar edhe gjyqtarja znj.Manjola Xhaxho (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për znj. Xhaxho, për të cilën, pas zhvillimit të shortit, caktoi si relator, z. Ilir Toska. Gjithashtu, me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për znj. Xhaxho, për të cilën vendosi që procedura e verifikimit e filluar më parë<sup>3</sup> është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020.

---

<sup>1</sup> Më datë 12.03.2020.

<sup>2</sup> Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

<sup>3</sup> Me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020.

10. Më datë 07.05.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

11. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

12. Më datë 12.05.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

13. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

14. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. Xhaxho.

15. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr.82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”<sup>4</sup>, “c”<sup>5</sup> dhe “ç”<sup>6</sup>, të pikës 5, të këtij*

---

<sup>4</sup> Në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

<sup>5</sup> Në shkronjën “c” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;...”.*

<sup>6</sup> Në shkronjën “ç” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

*vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...*”. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që janë kriteri i “*përvojës profesionale minimale*”, i “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*” dhe i “*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. Manjola Xhaxho u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

16. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. Manjola Xhaxho në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës administrative dhe civile, Këshilli me Vendimin nr.215, datë 18.06.2020 ka vendosur:

*“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. Manjola Xhaxho, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr.85, datë 26.02.2020...”.*

17. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

18. Duke vlerësuar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kandidaten znj. Manjola Xhaxho, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 85, datë 26.02.2020, relatori ia parashtrroi çështjen Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

19. Në Mbledhjen e datës 29.09.2020, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kandidatës për në Gjykatën e Lartë, znj. Manjola Xhaxho, për kriteret e pasurisë dhe të figurës, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe

vendosur për kualifikimin ose jo të kandidatës znj. Manjola Xhaxho në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 85, datë 26.02.2020.

20. Ndërkohë, më datë 09.09.2020, bazuar në nenin 146, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr.101/2020 (miratuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020), znj. Manjola Xhaxho u përzgjedh me short si anëtare e Kolegjit Zgjedhor. Zgjedhja e saj në këtë detyrë u miratua me Vendimin nr. 293, datë 09.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se *“Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë”*, procedura e verifikimit nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi *“apo ngritje në detyrë”*, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020.

21. Për rrjedhojë, me rënien e pengesës ligjore më datë 18.11.2020, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten u përfshi në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 04.12.2020.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS**

22. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

23. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”* (në vijim referuar si Vendimi 75/2019). Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, janë subjekt rivlerësimi kalimtar *“ex officio”*, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt

rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

24. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr.84/2016”, përcaktohet se: *“1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, do t’i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr.9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë. 7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.*

25. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatit që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të verifikimit të figurës, ky kandidat i nënshtrohet verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

26. Rezulton se kandidatja, znj. Xhaxho ti jetë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 19, datë 14.05.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 29.06.2018. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidatë u shtri për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e saj në detyrë.

#### **A. Për kriterin e pasurisë**

27. Për kandidaten Manjola Xhaxho u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32<sup>7</sup>, të Ligjit të Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

28. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten Manjola Xhaxho, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 185/24 prot., datë 25.06.2020.

28.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja Manjola Xhaxho ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

---

<sup>7</sup> "2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".

28.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja Manjola Xhaxho, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

29. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten Manjola Xhaxho u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

29.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 8498/1 prot., datë 03.06.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2331/1 prot., datë 05.06.2020, ku për kandidaten Manjola Xhaxho nuk rezulton të jetë e regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

29.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 9228/1 prot., datë 28.05.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2332/1 prot., datë 01.06.2020, ku për kandidaten Manjola Xhaxho nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

30. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidaten, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

31. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, nuk u konstatua papltoshmëri ose mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

32. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten Manjola Xhaxho janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të



skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e saj për emërimin në Gjykatën e Lartë, sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

## **B. Për kriterin e figurës**

33. Për kandidaten Manjola Xhaxho u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

34. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten Manjola Xhaxho, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit<sup>8</sup>, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni<sup>9</sup>.

35. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates Manjola Xhaxho me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

36. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten Manjola Xhaxho, në kushtet kur kjo candidate ka qenë magjistrate në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit

---

<sup>8</sup> Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

<sup>9</sup> Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

37. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 2334/1 prot., datë 27.05.2020, ku për kandidaten Manjola Xhaxho është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetdeklarimit më datë 22.04.2016; - formulari i vetdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb; - në formularin e vetdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

38. Kandidatja znj.Xhaxho iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është e datëlindjes 13.07.1975, sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019, pra më e hershme se Korrik 1977.

38.1 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 486/6 prot., datë 23.09.2020, Vendimin nr.446, datë 15.09.2020, me të cilin është vendosur:

*“1. Të informojë Institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 2339/1 prot., datë 17.08.2020, “Kërkesë”, për verifikimin e pastërtisë së figurës, përpara emërimit të 7 (shtatë) kandidatëve për Gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, se: a) Për zonjat dhe zotërinjtë ... 5. Manjola Nikollaq Xhaxho, ..., nga verifikimet e kryera deri tani, bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 28, gërma “ë” dhe 49 të tij, si dhe përcaktimeve të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se:*

- 1. Nuk kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;*
- 2. Nuk kanë qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit;*
- 3. Nuk kanë qenë anëtar të ish-Sigurimit të Shtetit deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të Nenit 29, pika 2 Ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*...”.*

39. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten Manjola Xhaxho janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të

skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e saj për emërimin në Gjykatën e Lartë, sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor, që në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj, mbi të cilat mund të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për për emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

### **III. KONKLUZIONE**

40. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. Manjola Xhaxho, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

41. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. Manjola Xhaxho, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I:**

1. Kualifikimin e kandidates znj.Manjola Xhaxho dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr.85, datë 26.02.2020.
2. Vendimi nr.215, datë 18.06.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj.Manjola Xhaxho sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**